



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 27.01.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Etem Arifi, Mexhide Mjaku – Topalli dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: , Lejla Selimi- OSBE, Mejreme Tahirukaj-RTK-RADIO, Agim Mangilaj-CSGD, Teuta Hoxha-YIHR-KS, Hamze Maliqi-SWOK, Mërgime Kajtazi-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Kryetaraja-fillimisht ju dëshiroj anëtareve të Komisionit punë të mbarë gjatë këtij viti, duke ju bërë thirrje edhe kolegeve të Opozitës që ti bashkohen punës së Komisionit, sepse në përbërje të plote do të jete puna më efikase,

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.12.2015 dhe 22.12.2015,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2015,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016,
5. Të ndryshme.

Kryetarja- konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- konstatoj se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.12.2015 dhe 22.12.2015,

Kryetarja- konstatoi se Komisioni miratoj procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me dt.8.12.2015 dhe 22.12.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2015,

Kryetarja- tha se Raportin e Punës së Komisionit e keni marrur me kohe, edhe ketu vrehet mungesa e kolegeve nga opozita dhe që ka reflektuar në punë, aktivitete e parapara në planin e punës nga viti 2015, shumica janë realizuar, ato çka kanë mbetur do të barten në planin e punës për vitin 2016, në këtë raport janë përfshirë pothuajse të gjitha ato që janë punuar në komision, komisioni gjatë vitit 2015 nuk ka mbajtur dëgjime publike edhe pse kanë qenë të parapara, por dihet se tri projektligjet Komisioni i ka kaluar me procedurë të përshpejtuar që është kërkuar nga Kuvendi dhe kjo ka diktuar që dëgjimet publike të anulohen. Po ashtu kemi qeshtja të hapura që kanë mbetur pa u kryer në vitin 2015, siq janë vizitat neper njësit për të Drejtat e Njeriut neper Komuna, Monitorimi i Ligjit për Mbrojtja nga Dhuna në familje po ashtu në procedurë është edhe Amendamenti i Projektligjit për të drejtat dhe statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Kryetarja- tha se për këto pike të rendit të ditës hapi diskutim.

Nenad Rashiq-pershendeti të praishmit dhe tha se në komision është angazhuar prej nëntorit të vitit 2015, dhe nuk mundem të ndërhy në esencë të raportit, por po i referohem qeverisë për një konstruktivitet pasi që si grup punës për shqyrtim të Projektligjit për të drejtat dhe statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, tri herë kemi ftuar përfaqësues të zyrave të ministrive dhe nuk kemi pasur përgjigje siq kemi dashur ne, dhe [përgaditja e dinamikës së projektligjit varet shumë nga ato konsulta që është dashur të bëhen me përfaqësues të qeverisë, në të ardhmen kjo të merret me seriozitet.

Salihe Mustafa-tha se si komision jemi munduar dhe kemi punuar, dihet se vitin e kaluar kemi kaluar pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut, kemi bërë monitorimin e ligjit për Personat e verber, jemi në procedurë të monitorimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, dihet se në komision kemi procedurë për leximin e parë në Kuvend Projektligjin për Lirite Fetare por uvendi nuk e ka kaluar në leximin e parë, tani kemi në shqyrtim projektligjin për paraplegjik dhe tetraplegjik dhe si komision jemi të përkushtuar që ta kryejmë punën sa më mirë, poashtu komisioni ka hartuar edhe Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të

Popullit dhe zevendesve, besoj se edhe punet qe i kemi ne procedure dhe te tjerat komisioni do ti realizoj me sukses.

Mexhide Mjaku-Topalli-përshëndeti te pranishmit dhe ju uroj hapjen e sesionit pranveror per kete vite, sa i perket Raportit te Punes se komisionit per vitin 2015, tha se eshte nje raport permbajtesor dhe gjithëpërshires, jane perfshire te gjitha aktivitetet qe i ka pasur komisioni, besoj qe edhe ne te ardhmen do te jemi bashkëpunues dhe do te kemi rezultate te mira, tha se si qeshtje e hapur na ka mbetur edhe udhëzuesi per peticione.

Etem Arifi-ne kete raport eshte paraqitur puna reale e komisionit, mbetet qe ne te ardhmen te punohet edhe me shume, eshte pare vullneti yne qe si deputet te qojem proceset përpara dhe ju deshiroj pune te mabre edhe ne te ardhmen.

Kryetarja-tha se nga e gjith kjo po del se te gjitha punet qe kan mbetur pa u kryer ne vitin 2015, do ti veme ne fokus gjate këtij viti, poashtu sa i perket pergjigjive te ministrive ne patem konsiderat sepse ishte fundi i vitit dhe kishin obligime, por edhe ata duhet te ken parasysh se e kan obligim ligjor qe te jen ketu.

Ajo tha se kemi pasur te planifikuar nje Vizite ne Bruksel, por per shkat se ka qen ne votim Buxheti i Republikes se Kosoves eshte pare e nevojshme qe te jemi prezent ne seanc dhe eshte anuluar vizita.

Kryetarja- kosnstaoi se ne fund te debatit Komisioni ne mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti i Punës se Komisionit për vitin 2015.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016,

Kryetarja- tha se sa i perket planitte punes per vitin 2016, keni pasur me kohe programin Legjislativ qe eshte proceduar nga Qeveria, Rapaortin e Progresit dhe besoj qe keni pasur kohe qe ti shiqoni, dhe qe te jepni kontributin e juaj qe plani i Punes te jete sa me i kompletuar, tani ne po diskutojm per krejt ato qe jan paraqitu ne kete drafte Plan Pune, eshte hyrja qe del si obligim edhe nga rregullorja e Kuvendit, mire me bere nje vërejtje per plotësim te stafit te Komisionit, sepse pas pensionimit te Kordinatorti te Komisionit, tani staf mbeshtets ka mbetur vetem zonja Sulltane, po io ndihmon edhe Burimi qe eshte i angazhuar nga Unicef, por dihet se Burimi ka ne Fokus te Drejtat e Femijeve edhe pse nuk kursehet me angazhimin e vet ne te gjitha punet e komisionit, por dihet se fusheveprimtarija e Komisionit eshte e gjere dhe eshte ngarkese edhe mbulimi me stafin mbshtetes, sepse eshte ngarkes edhe per Sulltanen dhe reflekton edhe ne pune tejra,

Kryetarja-n beri prezantimin e aktiviteteve te paraqitura sipas muajve ne kete Plan te Punes qe eshte paraqitur si draft, dhe kërkoj nga antert e komisionit qe nese kane diqka per te shtuar apo ndryshuar ti paraqesin propozimet e tyre, ajo tha se Hulumtimi per Projektligjin per te drejtat dhe

statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik eshte pergadiur dhe ju ka shperndare sot antareve te komisionit, është mire te koordinohemi dhe te mbajmë një takim lidhur me këtë për te koordinuar dinamiken e buneve lidhur me finalizimin e këtij projektligji,

Nenad Rashiq-tha se kemi pranuar kete hulumtim dhe njejher pe analizojme mire dhe propozoj qe nese kemi mundesi mu takuar te premten dhe te takohemi me punuesit e këtij hulumtimi dhe ti sqarojme disa gjera brenda hulumtimit dhe pastaj e nxjerrim një përfundim dhe ndoshta krejt ne fund te takohemi krejt se bashku dhe te njoftoheni me punët qe ka bere grupi punues dhe pastaj te organizojmë edhe një dëgjim publik.

Mexhide Mjaku- tha se po nderlidhem em e takimin e fundit te Komisionit qe kishim, ku ka qen shqetësuese dhe eshte paraqitur para nesh qeshtja e shoqates se HANDIKOSIt, ne prizeren dhe Ferizaj eshte diskutu kur te kemi vizita per njësitin e te drejtave te Njeriut ne keto komuna te vizitohet edhe kjo shoqate, a do te ishte e rruges qe te evidentohet edhe kjo qe perveq njesitti te te drejtave te njeriut te vizitohen edhe shoqatat e personave me aftesi te kufizuara neper komuna.

Kryetarja-per keto te gjitha do ti kemi parasysh sepse ka dalur si obligim i komisionit nga mbledhja e kaluar por fokusi do te mbetet keshtu, sepse kjo eshte vetem si udherrefyes e qka do qe paraqitet nevoja ne do ta plotesojm me aktivitete,

Nenad Rashiq-

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi

